

# Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Shkurt, 2014

Tiranë, më 10 Mars 2014: Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Shkurt 2014, arriti 118,7 % kundrejt muajit Dhjetor 2007 (Dhjetor 2007=100).

**Në muajin Shkurt 2014 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 1,9 %.** Një vit më parë ky ndryshim ishte 2,5 %. Krahasuar me muajin Shkurt 2013, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Pije alkoolike dhe duhan" me 6,3 % pasuar nga grupi "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me 5,6 %, "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 2,9 %, "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" me 2,0 %, "Hotele, kafene dhe restorante" me 1,9 % etj. Ndërsa ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Veshje dhe këpucë" me 3,4 %, pasuar nga grupi "Komunikimi" me 2,8 %, dhe "Shëndeti" me 1,3 % etj.

Rritja vjetore në muajin Shkurt është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 1,14 pikë përqind. Në këtë grup çmimet e nëngrupit "fruta" janë rritur me 16,7 % dhe nëngrupit "zarzavate" me 13,7 %. Ndërsa çmimet e nëngrupit "vajra dhe yndyrna" u ulën me 4,4 % pasuar nga nëngrupi "sheqer e ëmbëlsira" me 3,8 %, "kafe, çaj e kakao" me 1,6 %, "qumësht, djath e vezë me 0,6 % etj. Rritja e çmimeve të grupit "Pije alkoolike dhe duhan" ka kontribuar me 0,23 pikë përqind në ndryshimin vjetor. Krahasuar me një vit më parë çmimi i duhanit u rrit me 11,6 %. Çmimet e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" kanë kontribuar me 0,33 pikë përqind. Në këtë grup çmimet e materialeve për mirëmbajtjen e shtëpisë u rritën me 2,6 % dhe çmimi i ujit të pishëm me 0,7 %.

Rritja e çmimeve të grupit "Veshje dhe këpucë" ka ndikuar me - 0,18 pikë përqind në ndryshimin vjetor. Grupet "Mobilje e pajisje shtëpie" dhe "Komunikimi" kanë kontribuar me -0,07 pikë përqind.

**Në Shkurt 2014 ndryshimi mujor i indeksit është 1,4 %.** Rritja mujore e çmimeve është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 1,13 pikë përqind. Çmimet e zarzavateve u rritën me 17,4 % dhe çmimi i frutave me 1,9 %. Gjithashtu, rritja e çmimeve të grupit "Mallra dhe shërbime të ndryshme" ndikoi me 0,2 pikë përqind në ndryshimin mujor. Në këtë grup tarifatat e siguracionit të makinave u rritën me 27,6 %.

Çmimet e grupit "Transporti" kanë ndikuar me 0,02 pikë përqind në ndryshimin mujor. Çmimi i naftës dhe benzinës u rrit me 0,5 % krahasuar me një muaj më parë.

Për publikim 10/03/2014

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit





Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2007=100 %

Kodi	Grupet	Peshat	02 - 13	03 - 13	04 - 13	05 - 13	06 - 13	07 - 13	08 - 13	09 - 13	10 - 13	11 - 13	12 - 13	01 - 14	02 - 14
	<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>116,5</b>	<b>116,8</b>	<b>116,6</b>	<b>115,5</b>	<b>114,8</b>	<b>113,8</b>	<b>113,7</b>	<b>114,6</b>	<b>114,8</b>	<b>114,2</b>	<b>116,2</b>	<b>117,1</b>	<b>118,7</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	39,3	127,0	128,6	128,1	124,9	123,1	121,1	120,7	122,6	122,4	120,7	125,3	127,1	130,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,6	129,2	129,1	129,0	129,7	129,5	129,5	129,3	129,4	129,8	132,6	134,4	138,2	137,3
3	Veshje dhe këpucë	5,1	87,3	87,1	87,0	86,7	85,6	85,0	84,9	85,1	85,5	85,5	85,6	85,5	84,3
4	Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji	16,3	112,7	112,6	112,5	112,4	112,9	112,7	112,8	113,9	114,0	114,3	115,2	115,0	115,0
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	10,0	104,1	104,1	104,2	104,1	104,0	103,9	104,0	103,7	103,4	103,6	103,4	103,3	103,4
6	Shëndeti	3,4	123,6	123,6	123,6	123,6	123,4	122,3	121,7	121,9	121,9	121,9	121,7	122,0	122,0
7	Transporti	6,1	118,5	118,4	118,9	119,1	118,8	118,7	119,2	118,5	118,3	118,0	117,9	119,3	119,6
8	Komunikimi	2,6	82,3	82,3	82,3	82,2	82,2	82,2	82,2	82,3	79,9	79,9	79,9	80,0	80,0
9	Argëtim dhe kulturë	3,1	114,6	114,4	114,4	114,4	114,5	114,6	115,0	115,3	115,0	114,8	114,7	114,5	114,7
10	Shërbimi arsimor	1,4	108,9	108,9	108,9	108,9	109,3	109,3	109,3	109,1	109,0	109,0	109,0	109,3	110,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,2	109,0	108,9	109,0	109,1	109,5	109,6	110,2	110,8	110,9	110,9	110,9	110,8	111,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,9	110,7	105,6	105,6	108,4	107,9	107,1	107,5	107,0	112,2	111,9	112,2	112,4	116,9

Tab. 2 . Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	02 - 13	03 - 13	04 - 13	05 - 13	06 - 13	07 - 13	08 - 13	09 - 13	10 - 13	11 - 13	12 - 13	01 - 14	02 - 14
	<b>Gjithsej</b>	<b>1,1</b>	<b>0,3</b>	<b>-0,1</b>	<b>-1,0</b>	<b>-0,6</b>	<b>-0,8</b>	<b>-0,1</b>	<b>0,8</b>	<b>0,1</b>	<b>-0,5</b>	<b>1,7</b>	<b>0,8</b>	<b>1,4</b>
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,6	1,2	-0,4	-2,5	-1,4	-1,7	-0,4	1,6	-0,1	-1,4	3,8	1,4	2,9
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,3	0,0	-0,1	0,6	-0,2	0,0	-0,2	0,1	0,3	2,2	1,3	2,9	-0,7
3	Veshje dhe këpucë	-0,6	-0,3	-0,1	-0,4	-1,2	-0,9	-0,2	0,3	0,4	0,0	0,2	-0,1	-1,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,0	-0,2	0,0	-0,1	0,4	-0,1	0,1	0,9	0,2	0,3	0,8	-0,1	-0,1
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,1	0,0	0,1	0,0	-0,1	-0,1	0,1	-0,3	-0,2	0,1	-0,1	-0,1	0,1
6	Shëndeti	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	-1,0	-0,4	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,2	0,0
7	Transporti	-0,1	-0,1	0,4	0,1	-0,3	-0,1	0,5	-0,6	-0,1	-0,2	-0,1	1,2	0,2
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	-2,9	0,0	0,0	0,1	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	-0,1	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,1	0,3	0,3	-0,3	-0,2	-0,1	-0,2	0,2
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0	-0,2	0,0	0,0	0,0	0,2	0,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,1	0,0	0,1	0,1	0,4	0,0	0,6	0,5	0,1	0,0	0,0	0,0	0,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	-4,6	0,0	2,6	-0,4	-0,8	0,4	-0,5	4,9	-0,2	0,2	0,2	4,0

Tab. 3 Ndryshimet vjetore te indeksit

Kodi	Grupet	02 - 13	03 - 13	04 - 13	05 - 13	06 - 13	07 - 13	08 - 13	09 - 13	10 - 13	11 - 13	12 - 13	01 - 14	02 - 14
	<b>Gjithsej</b>	2,5	2,4	2,3	2,1	2,3	1,6	1,2	1,7	1,7	1,0	1,9	1,7	1,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,9	5,6	5,7	4,9	5,4	4,0	2,8	3,9	3,5	2,1	3,5	2,7	2,9
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,9	3,6	3,5	4,3	4,1	4,1	3,9	2,4	1,2	3,2	4,2	7,3	6,3
3	Veshje dhe këpucë	-3,2	-3,4	-3,4	-3,6	-4,5	-4,4	-3,8	-3,7	-3,8	-3,7	-3,4	-2,7	-3,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-0,1	-0,5	-0,9	-1,0	-0,5	-0,5	-0,5	1,5	1,6	1,5	2,3	2,0	2,0
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,4	1,3	1,2	0,7	0,5	0,4	0,5	0,2	-0,1	-0,1	-0,5	-0,7	-0,7
6	Shëndeti	1,1	1,1	0,1	0,1	-0,1	-1,0	-1,5	-1,4	-1,5	-1,6	-1,5	-1,3	-1,3
7	Transporti	0,6	-0,7	-0,3	0,5	1,1	0,5	0,3	-0,9	-1,0	-1,0	-1,2	0,6	0,9
8	Komunikimi	1,3	1,3	1,3	1,3	1,3	1,2	1,3	1,3	-1,4	-1,4	-2,9	-2,8	-2,8
9	Argëtim dhe kulturë	1,5	0,8	0,3	0,4	0,4	0,9	0,8	0,6	0,4	0,1	-0,2	-0,2	0,1
10	Shërbimi arsimor	1,8	1,8	1,8	1,8	2,2	2,2	2,2	2,0	0,1	0,1	0,1	0,3	1,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,9	1,7	1,8	1,5	1,9	2,1	2,7	3,1	3,0	2,5	1,9	1,8	1,9
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	1,4	-3,5	-3,6	-1,0	-1,6	-2,4	-2,0	-3,0	1,8	-1,2	3,3	1,6	5,6

%

# Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), duke filluar nga muaji Dhjetor 2007 llogaritet me shportën e artikujve, peshat e të cilave janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës së Buxhetit të Familjes, realizuar nga INSTAT gjatë periudhës Tetor 2006-Shtator 2007. Muaji Dhjetor 2007 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2007 = 100). Ndryshimi i mëparshëm i shportës së artikujve është bërë në muajin Janar të vitit 2002, ku numri total i artikujve u rrit nga 221 në vitin 1993 në 262 artikuj. Në shportë numri total i artikujve është 272. Indeksi llogaritet dhe publikohet duke përdorur strukturën e Klasifikimit të Shpenzimeve sipas Qëllimit (COICOP) me 12 grupe kryesore, tërësisht të përputhshëm me klasifikimin e shpenzimeve që përdor EUROSTAT..

Indeksi mbulon gjithë territorin e vendit, (urban-rural). Peshat e artikujve llogariten të veçanta për çdo prefekturë. Çmimet e artikujve mbliidhen në 11 qytetet-prefekturë, ku prefektura Kukës përfaqësohet nga prefektura Dibër. Çdo artikull i shportës përfaqësohet në indeks me peshën e tij gjeografike. Indeksi publikohet vetëm në nivel kombëtar.

Për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Shqipëri përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0,i}^t = \frac{\sum_i P_i^t * Q_i^0}{\sum_i P_i^0 * Q_i^0}$$

Peshat ( $w = P*Q$ ) e periudhës bazë janë përdorur për llogaritjen e indeksit:

$$I_{0,i}^t = \sum_i w_i * \left( \frac{P_i^t}{P_i^0} \right)$$

Në mënyrë më të detajuar, çmimi relativ është llogaritur për çdo produkt dhe çdo prefekturë duke përdorur mesataren gjeometrike :

$$PR_{t-1,ij}^t = \prod_{k=1}^n \left( \frac{P_{ijk}^t}{P_{ijk}^{t-1}} \right)^{1/n}$$

Ndryshimet mujore zinxhir japin çmimet relative krahasuar me periudhën bazë:

$$PR_{0,ij}^t = PR_{0,ij}^1 * \dots * PR_{t-1,ij}^t$$

IÇK rajonale llogaritet si më poshtë.

$$RIÇKI_{i,0}^t = \sum_j r_{ij} * PR_{0,ij}^t$$

Çmimet relative agregohen me peshat gjeografike për të formuar indekset e çdo produkti për gjithë Shqipërinë.

$$I_{0,i}^t = \sum_j r_{ij} * PR_{0,ij}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_j r_{ij} = 1 \quad : \quad \forall_i \text{ (për të gjitha rastet)}$$

Agregimi për të gjitha produktet jep IÇK e Shqipërisë:

$$CPI_0^t = \sum_i w_i * I_{0,i}^t \quad \text{ku:} \quad \sum_i w_i = 1$$

Legjenda:

P	çmimi
PR	çmimi relativ
I	indeksi
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
t	periudha korente t
t=0	periudha bazë 0
r	peshat gjeografike
ë	peshat e produkteve
j	numri i prefekturave
i	numri i produkteve

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm